




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.58/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 11, paragrafi 3 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa e z. Boban Aleksic, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, kundër Planit të Punës të Gjykatës Themelore Gjilan për vitin 2024.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga z. Boban Aleksic gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë, ankesën Nr.01/92, të datës 6 shkurt 2024, kundër Planit të Punës së Gjykatës Themelore në Gjilan, për vitin 2024. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se Plani i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan, parasheh transferimin e tij për vitin 2024, nga dega në Kamenicë në degën e gjykatës në Novobërdë, duke argumentuar se ky Plan shkel kushtetutën e vendit, ligjin për barazinë gjinore dhe ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në takimin 321-të të Këshillit, u shqyrtua ankesa e gjyqtarit z. Boban Aleksic dhe provat e bashkangjitura, ku në rastin konkret është vlerësuar se kemi të bëjmë me caktim apo transferim nga Gjykata Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë, në degën e Novobërdës, e cila hyn në kuadër të territorit të Gjykatës Themelore në Gjilan duke u bazuar në Ligjin për Gjykatat, si dhe i përgjigjet nivelit të kushteve të veçanta për gjyqtarë, sepse i njëjti caktohet apo transferohet nga Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë, në po të njëjtin departament-divizion të degës në Novobërdë.

Po ashtu, me vet faktin e miratimit të Planit të Punës së Gjykatës Themelore në Gjilan, për vitin 2024, është konsumuar kjo çështje, ngase KGJK e ka vlerësuar si të arsyeshme lëvizjen e gjyqtarit, pasi që në rastin konkret është në diskrecion të Kryetarit të Gjykatës që varësisht prej nevojave të gjykatës, përkatësisht vlerësimit të gjendjes së ngarkesës më lëndë, të caktoj gjyqtarët në degë, mirëpo me kusht që pas përmirësimit të gjendjes me lëndë në degën përkatëse, gjyqtari Aleksic, të kthehet përsëri në selinë kryesore të gjykatës.

Nga sa u tha më lart, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Albert ZOGAJ



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Boban Aleksic;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Gjilan;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Arkivit të KGJK-së.